



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJSH

MUAJI MARS



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Çfarë duhet të dimë për pranverën?



“Kuriozitete për stinën e pranverës”

- Stina e parë e vitit quhet pranverë. Tre muajt e pranverës janë: Marsi, Prilli dhe Maji. Pranvera fillon më 1 Mars, por në disa vende të botës fillon në data të tjera.
- Fillimi i pranverës lidhet me dukurinë e çeljes së luleve, zgjimin e shumë kafshëve dhe ardhjen e shpendëve shtegtarë. Në pranverë, qielli bëhet i kaltër, ditët zgjaten dhe ora ndryshon.
- Pranvera është stina e luleve shumëngjyreshe, koha kur ne admirojmë bukurinë e tyre dhe mbjellim fara të reja. Lulet karakteristike të pranverës janë: manushaqja, trëndafili, anemonet, jargavani, zambaku, tulipani.
- Në pranverë, në vendin tonë, më 14 Mars, festohet “Dita e Verës”, një festë kombëtare. Gjithashtu, muaji Mars shënon dhe festën e 7 Marsit - Festa e Mësuesve dhe 8 Marsit - Festa e Gruas.

Tema Mujore: Pranvera

Grupmosha 18-24 muaj

Java I: Karakteristikat e stinës së pranverës

Java II: Elementet kryesore të pranverës

Java III: Frutat dhe perimet e pranverës

Java IV: Veshja në pranverë



Tema Mujore: Pranvera





Tema Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Karakteristikat e stinës së pranverës	Njohja me disa karakteristika të stinës së pranverës (moti, natyra dhe bimësia).	Java I
Elementet kryesore të stinës së pranverës	Njohja me disa elemente të stinës (dielli, qielli, ylberi, fluturat, zogjtë) përmes krijimeve.	Java II
Frutat dhe perimet e stinës së pranverës	Njohja e frutave dhe perimeve të stinës përmes demonstrimit dhe përgatitjes së ushqimeve.	Java III
Veshja në pranverë, ngjyrat, format dhe numrat	Njohja e veshjeve të pranverës, ngjyrave, formave dhe numrave.	Java IV

Tema mujore: Pranvera



Tema e Javës: Pranvera




Java I	Tema	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p style="text-align: center;">Mirësevjen Pranverë!</p>	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve karakteristikat e stinës së pranverës - moti: i freskët, i ngrohtë; natyra: çelin lulet, lulet kanë ngjyra, pemët gjelbërohen; qielli: merr ngjyrë bojëqielli, blu. Edukatorja i konkretizon elementet me figura nga librat/revistat.</p> <p>Vjersha: “Manushaqe e vogël” Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se manushaqja është lulja që lajmëron pranverën.</p> <p>Kënga: “Erdhi pranvera” Shëtitje në oborr për të mbledhur gjethe dhe lule.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Libra, revista</p> <p>Lule natyrale</p>
E Martë	<p style="text-align: center;">Tabloja me gjethe dhe lule</p>	<p>Vjersha: “Manushaqe e vogël”/“Mimoza” Kënga: “Erdhi pranvera” Krijimi i tablosë: Edukatorja merr disa gjethe në oborr dhe bashkë me fëmijët ngjit gjethet në fletë (foto). Numërojmë, tregojmë me gisht dhe emërtojmë ngjyrat. Lojëra ndijore: Edukatorët i nxisin fëmijët të prekin materiale të ndryshme. Edukatorët emërtojnë dhe përforcojnë ndjesitë (i ftohtë-i ngrohtë/i ashpër-i lëmuar/i butë-i fortë, etj).</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Gjethe dhe lule natyrale, letra, karton</p> <p>Materiale të ndryshme në grup</p>






<p>E Mërkurë</p>	<p>Ngjyrat e pranverës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve se në pranverë, natyra gjallërohet: gjethet marrin ngjyrë të gjelbër, çelin lulet shumëngjyrëshe. Ngjyrat kryesore të pranverës janë: blu dhe e kaltër (qielli), e gjelbër/jeshile (gjethet, bari), e verdhë (mimozat), e kuqe (trëndafili), e bardhë (luledelet), vjollcë (manushaqe).</p> <p>Vjersha: “Manushaqe e vogël”/“Mimoza”. Edukatorja emërton ngjyrat e lules.</p> <p>Kënga: “Erdhi pranvera”</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin format e luleve/ gjetheve të përgatitura më përpara nga edukatorët. Punimet i ekspozojmë në mur/ te këndi.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Letra, lapsa me ngjyra</p> <p>Lule natyrale</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Dielli/ Shiu</p> 	<p>Kënga: “Si është koha”</p> <p>Në varësi të kohës zgjedhim aktivitetin:</p> <p>Dielli me bojëra: Fëmijët pikturojnë me duar për të formuar një diell (si në foto).</p> <p>OSE</p> <p>Shiu: Me pambuk krijojmë retë dhe me letra të prera në formë pikash uji, improvizojmë shiun (foto).</p> <p>Vjersha: “Shiu”</p> <p>Përrallë e lirë sipas librave që ndodhen në grup.</p> 	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Pambuk, letra me ngjyra, bojëra</p> <p>Libra me përralla</p>
<p>E Premte</p>	<p>Lulet</p> 	<p>Përsëritje e këngëve dhe vjershave të javës.</p> <p>Shëtitje në oborr për të mbledhur gjethe dhe lule.</p> <p>Krijim me brumë: Edukatorja përgatit brumin. Fëmijët ngjisin në të lule dhe gjethe, të mbledhura më parë në oborr.</p> <p>Muzikë për fëmijë dhe lojëra lëvizore.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Gjethe dhe lule natyrale</p> <p>Miell, ujë, kripë (brumë)</p>


Tema mujore: Pranvera



Tema e Javës: Elementet Kryesore të Pranverës

Java II	Tema	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E hënë</p>	<p style="text-align: center;">Festa e Edukatores 7 Marsi</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;">   </div>	<p>Vjersha dhe këngë për edukatoren.</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për festën e 7 Marsit, ditën e mësueses/ edukatores. Rëndësia e kësaj feste për vendin tonë, si festohet ajo. I nxit fëmijët me pyetje, duke konkretizuar me prindër të fëmijëve që mund të punojnë si mësues/e. Mund të ftojnë një prind që është mësues, tregojnë foto, etj.</p> <p>Krijim: Lule/kartolina për edukatorët përmes pikturimit me gishta duke përdorur ngjyra të ndryshme dhe letra me ngjyra, mjete të riciklueshme (foto).</p> <p>Krijojmë muzikë duke përdorur mjete rrethimore të grupit dhe kërcëjmë sipas ritmit.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Letra me ngjyra, bojëra për pikturim me gishta</p> <p>Materiale të ndryshme në grup për të krijuar një ritëm muzikor</p> <div style="text-align: center;">  </div>


<p>E martë</p>	<p>Festa e Mamin 8 Marsi</p> 	<p>Vjersha për mamin/ nënën/ gjyshen.</p> <p>Biseda: Edukatorja iu flet fëmijëve për domethënien e 8 Marsit, festën ndërkombëtare të grave, dita kur ne i shprehim dashurinë mamin, gjyshes dhe grave të rëndësishme në jetën tonë, që i duam.</p> <p>Krijojmë kartolina/ tufa lulesh për mamin, me mjete të riciklueshme, pikturim me gishta (si në foto).</p> <p>Muzikë, kërcim, lojëra lëvizore.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve Letra me ngjyra, bojëra, lule natyrale, etj.</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Zogjtë</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në pranverë zogjtë shtegtojnë (udhëtojnë) nga vendet e ftohta në vendet e ngrohta. Zogjtë kanë sqep, pendë, bisht dhe i krijojnë foletë në pemë, por edhe pranë njerëzve (në ballkon).</p> <p>Vjersha: “Dallëndyshja”/ “Zogu ciu-ciu”</p> <p>Punë dore: Krijojmë zogj me duar (si në foto).</p> <p>Përrallë: “Rosaku i shëmtuar”</p>	
<p>E Enjte</p>	<p>Flutura</p> 	<p>Vjersha: “Flutura”</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për fluturat, të cilat mbushin lëndinat në stinën e pranverës. Fluturat fluturojnë dhe kanë shumë ngjyra.</p> <p>Përrallë: “Tri fluturat”</p> <p>Punë dore: “Krijimi i fluturës” me duart e fëmijëve. Edukatorja ndihmon fëmijët të krijojnë në letër ose në karton një flutur (foto).</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve Libër me përralla Letra, bojëra për pikturim me gishta</p>




E Premte	Mbjellja e lules 	Përsëritje e këngëve dhe vjershave të javës. Aktivitet: Mbjellja e lules në oborr ose në vazo. Loja: “Ujitja e lules”. Edukatorja, bashkë me fëmijët, ujin një lule të mbjellë në vazo ose në oborrin e çerdhes. Edukatorja emërton pjesët e lules (petalet, gjethet, kërcelli), fëmijët i tregojnë me gisht ose i emërtojnë. Vjersha: “Mos e këput lulen”.	Manuali i vjershave dhe këngëve Lule, dhe/ vazo, enë ujitjeje
-----------------	--	--	--


Tema mujore: Pranvera




Tema e Javës: Frutat dhe Perimet e Stinës






Java III	Tema	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Frutat e stinës së pranverës 	Vjershë: “Kalitja fizike” Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve frutat e stinës, përmes demonstrimit me fruta të vërteta, forma plastike dhe libra. Punë dore: Edukatorja vizaton dhe pret disa forma frutash dhe ndihmon fëmijët të ngjisin frutat në një tablo/ fletë. Gjëagjëza: “Qershia”. Kënga: “Sa i dua frutat”.	Manuali i vjershave dhe këngëve Letra, ngjyra, ngjitës, fruta

<p>E Martë</p>	<p>Perimet e stinës së pranverës</p> 	<p>Vjersha: “Kalitja fizike” Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve perimet e stinës së pranverës përmes demonstrimit me perime të vërteta, forma plastike dhe libra. Punë dore: Edukatorja përgatit forma perimesh prej letre dhe i ndihmon fëmijët të ngjisin frutat në tablo/ fleta letre. Gjëagjëza: “Karota” Përrallë e lirë në grup.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Perime, letër, gërshërë, ngjitës</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitja e ushqimeve</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve sesi përgatitet byreku dhe supa. Përmend përbërësit e byrekut: miell, ujë, gjalpë, vezë, djathë dhe të supës: ujë, vaj, qepë, erëza, mish, perime, etj. Përralla: “Byreku i mbretit”. Lojë: “Bëj sikur gatuj”. Edukatores, bashkë me fëmijët, gatujnë supë/byrek (fëmijët ndahen në dy grupe: njëri grup përgatit supën, tjetri byrekun). Vjersha: “Etika e të ngrënit”</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Përralla, sete gatimi, përbërësit e gatimit sipas recetës që do të gatuhet</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Etika e të ngrënit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve kush gatuan në çerdhe, emërton llojet e ushqimeve që konsumojnë fëmijët në drekë dhe mjetet që përdorin kur gatujmë. Pyet fëmijët: <i>Cilat ushqime ju pëlqejnë më shumë? Kush gatuan në shtëpi? Po në çerdhe?</i> Aktivitet: Kuzhinierja viziton grupin e fëmijëve dhe iu shpjegon fëmijëve se si po përgatitet ushqimi i ditës (duke marrë disa mjete për demonstrim). Vjersha: “Etika e të ngrënit” Punime me plastelinë: Fëmijët formojnë me plastelinë fruta, perime, kek, pica, etj.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Plastelinë, set gatimi, arush/ kukull</p>

E Premte	Shtrimi i tavolinës 	Lojë me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve sesi shtrohet tryeza. Emërton sendet: mbulesa e bukës, kartpercatat, lugët, gotat, pjatat. Fëmijët i identifikojnë ato me gisht dhe i emërtojnë. Loja imituese: “Shtrimi i tryezës” Përralla: “Supa me radhiqe”/ “Biskota e fundit”.	Mjetet që fëmijët përdorin për ushqyerjen Libri “365 rrëfenja para gjumit” Libri “Tutu mëson të dëgjojë”
-----------------	---	---	--

Tema mujore: Pranvera			
Tema e Javës: Numrat, format dhe ngjyrat			
Java IV	Tema	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Veshja e fëmijëve në pranverë 	Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në pranverë vishemi me rroba më të lehta se në dimër dhe konkretizon me një arush duke iu treguar fëmijëve ç’ka veshur arushi. Ngjyrosje: “Veshjet e fëmijëve” – Fëmijët ngjyrosin forma të përgatitura më parë nga edukatorët. Ekspozita: Fëmijët ekspozojnë veshjet e ngjyrosura dhe identifikojnë ngjyrat që kanë përdorur. Përralla: “Hirushja” Vjersha: “Unë tani u rrita”.	Manuali i vjershave dhe këngëve Letra, lapsa me ngjyra Libër me përralla
E Martë	Numrat 1-3 	Vjersha: “Këtu jam unë”. Bisedë: Edukatorja emërton numrat nga 1 deri në 3 dhe i konkretizon me topa ose objekte të tjera të ngjashme. Kënga: “Lepuri” (kënga fillon me numërimin: 1, 2, 3, 4, 5). Lojë me rathë: kërcim nga njëri rreth në tjetrin, numërim (foto) 	Manuali i vjershave dhe këngëve Letra, ngjyra, lapustila, rathë

<p>E Mërkurë</p>	<p>Rrethi</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve rrethin duke përdorur figura prej kartoni të përgatitura më parë. Konkretizon formën e rrethit me objekte (topi, ora) ose elemente natyrorë (dielli).</p> <p>Aktivitet: Edukatorja vizaton në një fletë formati një rreth të madh. Fëmijët ndihmohen të vendosin figurën e rrethit tek rrethi i vizatuar. Mund të ngjiten.</p> <p>Loja: Brenda dhe jashtë (rrethit). Edukatorja demonstroi konceptin “brenda” dhe “jashtë” rrethit dhe iu kërkon fëmijëve të kërcejnë brenda dhe jashtë tij (duke përdorur rrathët e mëdhenj që keni në grup).</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Letra, lapsa, objekte në formë rrethi</p> <p>Rrathë</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Ngjyrat</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve katër ngjyrat bazë: E kuqe, blu, e verdhë, e gjelbër. Ua konkretizon me objekte të ndryshme në dhomë ose me veshjet e fëmijëve.</p> <p>Aktivitet: Fëmijët ngjisin topat shumëngjyrësh në krahët e fluturës (foto)</p> <p>Vjersha: “Këtu jam unë”.</p> <p>Përrallë: “Tri fluturat”</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Topa, kartona me ngjyra, ngjitës</p> <p>Libër me përralla</p>
<p>E Premte</p>	<p>Shkojmë për piknik</p> 	<p>Përsëritje e këngëve dhe vjershave të javës.</p> <p>Aktivitet: Edukatorët së bashku me fëmijët improvizojnë një piknik, duke u bazuar tek përralla “Pikniku i arushit Tedi”.</p> <p>Përralla: “Pikniku i arushit Tedi”.</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin forma ushqimesh të përgatitura më përpara nga edukatorja.</p>	<p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Libri me përralla</p> <p>Mjete për të shkruar në piknik</p>